



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E FINANCAVE**

**UDHËZIM**

**“PËR**  
**PËRGATITJEN E BUXHETIT TË SHITETIT DHE FONDET SPECIALE”**

**PËRMBAJTJA**

A. HYRJE.....	3
A. 1. KUADRI MENAXHUES I PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM.....	3
A. 2. METODAT E PËRGATITJES SË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM .....	4
A. 3. TAVANET PËRGATITORE TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM .....	4
A. 4 AFATET PËR PËRGATITJEN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM, SIPAS KALENDARIT TË MENAXHIMIT TË SHPENZIMEVE PUBLIKE (MSHP).....	4
B. DOKUMENTA PËR T’U KONSULTUAR .....	4
C. KUADRI MAKROEKONOMIK DHE FISKAL 2012-2014 .....	4
D. TAVANET PERGATITORE TE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM .....	5
E. PROGRAMI BUXHETOR AFATMESEM 2012-2014 .....	6
F. PROCEDURAT PËR PËRGATITJEN E KËRKESAVE BUXHETORE TË PROGRAMIT .....	7
F. 1. RISHIKIMI I POLITIKES SE PROGRAMIT .....	7
F. 2. PLANIFIKIMI I SHPENZIMEVE TE PROGRAMIT .....	7
F. 3. KËRKESA SHITESË PËR SHPENZIME NË PROGRAMIN BUXHETOR AFATMESEM 2012-2014. ....	7
F. 4. PROCEDURAT E MENAXHIMIT TE INVESTIMEVE PUBLIKE.....	8
G. RAPORTET – PJESË E KËRKESAVE BUXHETORE .....	8
H. ANALIZA DHE VLERËSIMI I KËRKESAVE BUXHETORE.....	9
H. 1. ROLI I MINISTRISË SË FINANCAVE NË FAZËN E ANALIZËS SË KËRKESAVE BUXHETORE .....	9
H. 2. ROLI I DEPARTAMENTIT TË BASHKËRENDIMIT TË STRATEGJIVE DHE KOORDINIMIT TË NDIHMËS SË HUAJ (DEBASKON), NË FAZËN E RISHIKIMIT TË POLITIKËS SË PROGRAMIT (RPP) .....	9
H. 3. ROLI I MINISTRISË SË INTEGRIMIT, NË FAZËN E RISHIKIMIT TË POLITIKËS SË PROGRAMIT DHE PLANIFIKIMIT TË SHPENZIMEVE TË PROGRAMIT .....	9
H. 4. NEGOCIATAT ME MINISTRITË E LINJËS/INSTITUCIONET BUXHETORE (ANEKSI NR. 8).....	9
I. MONITORIMI DHE VLERËSIMI I PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM (PBA) 2012-2014. ....	9
J. NDJEKJA E PROCESIT DHE MBËSHITETJA KËSHILLIMORE .....	10
K. UDHËZIMI PLOTËSUES I PËRGATITJES SË BUXHETIT.....	10

## **ANEKSET**

- Aneksi 1**      Kuadri Menaxhues i Programimit Buxhetor Afatmesëm 2012-2014
- Aneksi 2**      Urdhëri i Kryeministrit mbi GSBI
- Aneksi 3**      Proçedurat e Rishikimit të Politikës së Programit
- Aneksi 4**      Proçedurat e Planifikimit të Shpenzimeve të Programit
- Aneksi 5**      Proçedurat e Manaxhimit të Investimeve Publike
- 5.A Forma e Propozimit të Projektit (FPPI)
- 5.A.1. Udhëzues për plotësimin e FPPI
- 5.B. Forma e Projekt Idesë (FIIP)
- 5.C. Forma e Analizës Kosto - Përfitim (FAKP)
- Aneksi 6**      Kalendari i PBA-së 2012-2014
- Aneksi 7**      Pasqyrat Plotësuese të Buxhetit
- Aneksi 8**      Kalendari i Takimeve të Negociatave të Buxhetit
- Aneksi 9**      RPP e institucioneve

## **Tabelat e Tavanëve**

- Tabela 1**      Tavanet Përgatitore të PBA 2012-2014



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E FINANCAVE**

**UDHËZIM**

**Nr. 8 Datë 02.03.2011**

**“PËR**  
**PËRGATITJEN E BUXHETIT TË SHTETIT DHE FONDET SPECIALE”**

Në përputhje me Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008, neni 24, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ministri i Financave,

**U D H Ë Z O N:**

**A. HYRJE**

1. Ky udhëzim përcakton:
  - *Përgjegjësitë e Ministrisë së Financave dhe Ministrive të Linjës/Institucioneve Buxhetore;*
  - *Procedurat për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesem 2012-2014;*
  - *Tavanet Përgatitore të Programit Buxhetor Afatmesem 2012-2014, si dhe*
  - *Afatet për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesem 2012-2014.*

**A. 1. Kuadri Menaxhues i Programit Buxhetor Afatmesem.**

2. Kuadri menaxhues i PBA-së paraqitet në **Aneksin 1** të këtij Udhëzimi. Ai përbëhet nga 3 seksione, si më poshtë:
3. Seksioni 1 i Aneksit 1, paraqet një përmbledhje të Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI).
4. Seksioni 2 i Aneksit 1, paraqet një përmbledhje të 7 mbledhjeve kryesore të GSBI-ve dhe 6 mbledhjeve kryesore të EMP-ve, në referencë të Urdhrit të Kryeministrit Nr.78 datë 08.05.2006 “Mbi Krijimin e Grupeve për Strategji, Buxhet dhe Integrim”, (shikoni Aneksin 2)<sup>1</sup>
5. Në Seksionin 3 të Aneksit 1, përcaktohen rolet dhe përgjegjësitë në Ministrinë e Linjës/Institucionet Buxhetore, përkatësisht për:
  - Ministrat /Titullarët e Institucioneve Buxhetore,
  - Nëpunësit autorizues/Koordinatorët e GSBI-ve,
  - Drejtuesit e Ekipeve të Menaxhimit të Programeve (DEMP-ve),
  - Drejtoret e Drejtorive Ekonomike/Financës,
  - Drejtorët e Teknologjisë së Informacionit.
6. **Është e rëndësishme të kihet parasysh që:**
  - Përgatitja e buxhetit vjetor është pjesë përbërëse e procesit të përgatitjes së PBA-së;
  - ***Buxheti vjetor do të jetë viti i parë i PBA-së;***
  - Përgatitja e Buxhetit për vitin 2012, fillon në fund të muajit Shkurt me Rishikimin e Politikës së Programit dhe përfundon në muajin Dhjetor me përfundimin e komponentit të monitorimit të Planeve të Integuara të Ministrisë.

<sup>1</sup> Emërtimi i GSBI-ve (Grupi për Strategji, Buxhetim dhe Integrim) do të ndryshohet në GMS, (Grupi për Menaxhimin Strategjik) në bazë të Ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Neni 27. GMS do të trajtojë të gjitha çështjet e menaxhimit financiar brenda njësisë publike (duke përfshirë dhe detyrat e caktuara me Urdhërin e Kryeministrit Nr. 78, date 8.05.2006). Në bazë të Ligjit Nr. 10296, një udhëzim i vecantë i Ministrit të Financave do të trajtojë funksionimin e GMS.

## A. 2. Metodatat e Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm

7. Metodatat e përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2012-2014, parashtrihen në 3 grupe procedurash:
  - Rishikimi i Politikës së Programit (**Aneksi 3**)
  - Planifikimi i Shpenzimeve të Programit (**Aneksi 4**)
  - Menaxhimi i Investimeve Publike (**Aneksi 5**)
8. Anekset shoqëruese nga 1 deri 9 -të , përbëjnë një pjesë integrale të këtij Udhëzimi.

## A. 3. Tavanet Përgatitore të Programit Buxhetor Afatmesëm

9. Tavanet Përgatitore të PBA, në nivel qendror janë miratuar nga Këshilli i Ministrave me VKM nr.147 datë 02.03.2011 “Për miratimin e Tavanëve Përgatitore të Shpenzimeve Buxhetore të Programit Buxhetor Afatmesëm 2012-2014”.
10. Kërkesat buxhetore duhet të jenë detyrues brenda katër tavanëve.

## A. 4 Afatet për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm, sipas Kalendarit të Menaxhimit të Shpenzimeve Publike (MSHP)

11. Afatet e përcaktuara në këtë udhëzim, janë miratuar me VKM nr.2 datë 06.01.2011 “Për miratimin e Kalendarit të vitit 2011, për Menaxhimin e Shpenzimeve Publike”, i cili paraqitet në **Aneksin 6**.
12. Datat kryesore të Kalendarit të Menaxhimit të Shpenzimeve Publike, për qëllime të këtij Udhëzimi, janë:
  - Afati për dorëzimin e Kërkesave të Programit Buxhetor Afatmesëm 2012-2014, pas **Raundit të 1-rë, është deri më datë 29 Prill 2011;**
  - Drafti i parë i PBA-së, duhet të paraqitet nga Ministria e Financave në Komitetin e Planifikimit Strategjik pranë Këshillit të Ministrave, brenda datës **17 Qershor 2011;**
  - Udhëzimi Plotësues i Përgatitjes së Buxhetit, duhet të shpërndahet tek ministrat/institucionet buxhetore pas miratimit të draftit të parë të Programit Buxhetor Afatmesëm 2012-2014 nga Këshilli i Ministrave, brenda datës **08 Korrik 2011.**
  - Afati për dorëzimin e Kërkesave të Programit Buxhetor Afatmesëm 2012-2014, pas **Raundit 2-të, është deri më datë 31 Gusht 2011.**
  - Datat e negociatave të PBA-së 2012-2014, (midis GSBI-ve të Ministrisë së Linjës/ institucioneve dhe Ministrisë së Financës) pas përfundimit të Raundit 1 dhe 2 të Programit Buxhetor Afatmesëm 2012-2014, paraqiten në **Aneksin 8**.
13. Ndëshkimet e parashikuara në nenin 71 të Ligjit nr.9936 datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” do të zbatohen për nëpunësit autorizues, në çdo rast të mundshëm të mosrespektimit të këtij udhëzimi.

## B. Dokumenta për t'u konsultuar

14. Dokumentat e mëposhtëm duhet të merren në konsideratë nga ana e ministrave/institucioneve gjatë procesit të hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2012-2014, sidomos në fazën e Rishikimit të Politikave të Programit:
  - *Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim,*
  - *Strategjitë sektoriale,*
  - *Strategjitë ndër-sektoriale,*
  - *Marrëveshja e Stabilizimit -Asociimit (MSA),*
  - *Instrumentat e Para-Aderimit në BE (IPA)*
  - *Analiza e Shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2011-2013, e kryer nga ekipi analizues, pranë Ministrisë së Financave.*

## C. Kuadri Makroekonomik dhe Fiskal 2012-2014

15. Këshilli i Ministrave miratoi Kuadrin Makroekonomik dhe Fiskal me VKM nr.69 datë 02.02.2011 “Për miratimin e Kuadrit Makroekonomik dhe Fiskal për periudhën 2012-2014”.
16. Kuadri Makroekonomik dhe Fiskal 2012-2014, përcakton kontekstin makroekonomik për Programin Buxhetor Afatmesëm 2012-2014.

17. Ai pasqyron parashikime të treguesve financiar të buxhetit të Qeverisë për tre vitet e ardhshme, duke ofruar vlerësime të burimeve që Qeveria do të ketë në dispozicion për të financuar shpenzimet e saj.
18. Keto vlerësime sigurojnë bazen për Keshillin e Ministrave për të përcaktuar Tavanet e Shpenzimeve të PBA-se, të pasqyruar në Seksionin D të këtij Udhezimi.
19. Zbatimi i politikave makroekonomike të qeverisë për Programin Buxhetor Afatmesëm 2012-2014, synon në:
  - Vijimësinë e konsolidimit fiskal, forcimi i mëtejshëm i administrimit dhe menaxhimit të të ardhurave, rritja e efikasitetit të shpenzimeve publike, zgjatja e afatit të maturimit të reduktimi i nivelit të borxhit të brendshëm, adresimi i financimit të huaj kryesisht në financimin e shpenzimeve kapitale, përmirësimi në balancet korente dhe primare, marrja e masave rregullative të tregut dhe përdorimi i incentivave fiskale që sigurojnë mbështetjen e investimeve publike dhe private;
  - Ndjekjen e politikave makroekonomike efektive si dhe thellimin e mëtejshëm të reformave ekonomiko-strukturore, krahas proceseve të tjera të natyrshme në të cilat po kalon ekonomia si progresi teknologjik, akumulimi i kapitalit e ristrukturimi i ekonomisë drejt një ekonomie gjithnjë e më efikente, me qëllim që të sigurohet vazhdimësia e ecurisë ekonomike përgjatë Programit Buxhetor Afatmesëm 2012-2014.
  - Ruajtjen e ritmeve relativisht të larta të rritjes ekonomike, ku për periudhën 2012-2014 parashikohet të jetë në nivelet e 6 – 6.2 përqind. Më specifikisht, rritja ekonomike për këto tre vite parashikohet të jetë, 6.1% për vitin 2012; 6.2% për vitin 2013; dhe 6.0% përqind për vitin 2014.
  - Ndjekjen e një politike monetare të kujdesshme, mbajtja e inflacionit brenda intervalit 2.8 deri në 3 përqind, koordinim edhe më efikas i politikës fiskale e monetare, dhe ruajtja e stabilitetit financiar.
  - Ruajtjen e pozicionit të qëndrueshëm të bilancit të pagesave, e shprehur në: (i) mbajtjen e një niveli të mjaftueshëm të rezervave valutore, (ii) reduktim të deficitit të llogarisë korente, (iii) rritje të investimeve të huaja direkte dhe hyrjeve neto kapitale.
20. Bazuar në buxhetin e vitit 2011, në kuadrin makroekonomik, në politikat fiskale dhe përmirësimet administrative që do ndërmerren, të ardhurat e buxhetit të shtetit gjatë periudhës 2012-2014 parashikohen të rriten në mënyrë graduale e të qëndrueshme. Në vitin 2012, të ardhurat parashikohen të jenë rreth 26.5 përqind e PPB (ose rreth 377.338 milion lek), 26.7 përqind e PBB në vitin 2013 (ose 411.127 milion lek) dhe 27.1 përqind e PBB në vitin 2014 (ose 448.051 milion lek).
21. Bazuar në nivelin e të ardhurave buxhetore dhe nivelin e burimeve të financimit të deficitit buxhetor, shpenzimet totale buxhetore për periudhën 2012-2014 parashikohen përkatësisht:
  - a) në masën 420.1 miliard lekë ose 29.5% e PBB në vitin 2012,
  - b) në masën 457.2 miliard lekë ose 29.7% e PBB në vitin 2013
  - c) në masën 497.6 miliard lekë ose 30.1% e PBB në vitin 2014.

Burimet do të përdoren kryesisht për ruajtjen e deficitit buxhetor në masën 3.0% të PBB-së, rritjen e diferencuar të pagave, rritjen e pensioneve mesatarisht 8% në vit dhe për mbajtjen e një ritmi të qëndrueshëm të investimeve mesatarisht në rreth 5.6% të PBB. Shpenzimet korente parashikohen përkatësisht në masën 23.8% të PBB, në vitet 2012 e 2013 dhe në masën 23.5% të PBB në vitin 2014

#### **D. Tavanet Pergatitore të Programit Buxhetor Afatmesëm**

22. Tavanet Pergatitore të PBA-se ndahen në 2 pjesë:
  - *Tavanet Totale të Shpenzimeve;*
  - *Tavanet Pergatitore të PBA-se për çdo ministri/institucion buxhetor.*
23. Tavanet Pergatitore të PBA 2012-2014 për çdo ministri/institucion buxhetor, përbejnë opsionin e Qeverisë për alokimin strategjik të taveveve totale, në nivel ministrie linje/institucioni buxhetor.
24. Tavani Pergatitor i PBA-se për çdo ministri/institucion buxhetor ndahet në 5 nen-tavane, të cilat janë:
  - *Shpenzimet e Personelit* – në këto nen-tavan përfshihen të gjitha shpenzimet për paga sipas **politikave ekzistuese** të pagave dhe numrit të miratuar të punonjesve për vitin 2011. Implikimet financiare të çdo politike e re që do të ndërmerret në legjislativë e pagave përlogariten dhe shtohen përkatësisht nga Ministria e Financave.

- Shpenzimet e Tjera Korrente – ne kete nen-tavan perfshihen te gjitha shpenzimet e tjera korrente te tilla si shpenzimet operative dhe mirembajtje (602), subvencionet (603), transfertat e brendshme (604), transfertat e huaja (605) dhe transfertat tek buxhetet familjare/individet (606). **Keto tavane synojne rritjen e shpenzimeve te funksionimit dhe te mirembajtjes si dhe uljen e ndjeshme ne shpenzimet e mirefillta administrative.**
  - Investimet e Brendshme – ne kete nen-tavan perfshihen shpenzimet kapitale per rritjen e aktiveve te brendshme te trupezuara dhe te patrupezuara te financuara me burimet e buxhetit te shtetit, kostot lokale, pagesat e TVSH dhe detyrime te tjera doganore per investimet e huaja (230-231).
  - Investimet e Huaja – Fondi i investimeve nga burime te huaja eshte percaktuar duke mbajtur parasysh projektet e parashikuara ne dokumentin e meparshem te PBA 2011-2013. Megjithate mund te ndodhe qe Ministritë e Linjës/Institucionet Buxhetore të kenë angazhime për marrjen e financimeve të huaja për të cilat Ministria e Financës mund të mos ketë informacion. Në këtë rast, këto financime të huaja duhet të paraqiten duke përdorur procedurat për Kërkesat Shtesë të PBA dhe konkretisht **në rastet kur:**
    - tavanet e vendosura nga KPS per financime te huaja nuk jane te mjaftueshme per te financuar projektet e programuara apo te mbulojne kerkesat per financimin e strategjive sektoriale apo nder sektoriale, atehere ministrite e linjes/institucionet buxhetore duhet te paraqesin kerkesa shtese per financimim e ketyre nevojave.
    - keto kerkesa shtese per financime te huaja gjenerojne kosto lokale, TVSH, shpenzime korente etj., kerkesat per mbulimin e ketyre kostove nga buxheti duhet te paraqiten vetem si kerkesa shtese per shpenzime buxhetore ne PBA.
    - nje kerkesa shtese per financime te huaja paraqitet, atehere ministrite e linjes/institucionet buxhetore duhet te paraqesin edhe deklaratën e politikës së programit të rishikuar, e cila duhet të tregojë ndryshimet respektive të qëllimeve, objektivave apo standartet e politikës që duhet të arrihen me ane të kerkeses shtese per financime te huaja.
    - kerkesat shtese per financime te huaja do te rishikohen nga Ministria e Financave dhe Departamenti i Bashkerendimit te Strategjive dhe Koordinimit te Ndhimes se Huaj (DEBASKON) dhe te diskutohen me ministrite e linjes/institucionet buxhetore gjate pergatitjes se draftit te pare te PBA.
    - ne rast se nuk ka kufizime te kuadrit makroekonomik aprovimi i tavaneve te ndryshuara te financimeve te huaja duhet te behet me aprovimin nga Komiteti i Planifikimit Strategjik te draftit te pare te PBA .
    - per projektet e prezantuara nepermjet kerkesave shtese per financime te huaja ministrite e linjes/institucionet buxhetore duhet te demostrojne se: (i) per projektet e prezantuara ne kerkesat per financime shtese per vitin 2012 ka angazhime konkrete nga donatoret per fonde qe do te disbursohen ne 2012; (ii) per projektet e prezantuara ne kerkesat per financime shtese qe do te fillojne ne vitin 2013 ose 2014 donatoret jane angazhuar ose priten angazhime per projekte.
  - Fondet Speciale – ne kete nen-tavan perfshihen shpenzimet e parashikuara per t'u kryer nga te ardhurat e veta dhe transfertat nga Buxheti Qendror per buxhetet e ISSH, ISKSH dhe Fondi Special per Kompensimin e Ish Pronareve.
25. Tavanet Pergatitore te PBA 2012-2014 per Ministrite/institucionet buxhetore tregohen ne Tabelen 1 qe shoqeron kete Udhezim.
26. Te gjithë Ministrat/Titullaret e institucioneve buxhetore duhet t'i paraqesin kerkesat per PBA **brenda Tavaneve Pergatitore te PBA 2012-2014.**

## E. Programi Buxhetor Afatmesem 2012-2014

27. Dokumenti i Programit Buxhetor Afatmesëm 2012-2014, përgatitet nga Ministria e Financave, duke u mbështetur në:
- *Kuadrin Makroekonomik 2012-2014;*
  - *Kërkesat e ministrive/institucioneve buxhetore për Programin Buxhetor Afatmesëm 2012-2014;*
  - *Kërkesat Shtesë për Programin Buxhetor Afatmesëm 2012-2014;*

28. Dokumenti i Programit Buxhetor Afatmesem 2012-2014, në bazë të VKM nr.2 datë 06.01.2011 “Për miratimin e Kalendarit të Menaxhimit të Shpenzimeve Publike”, dërgohet për miratim në Komitetin e Planifikimit Strategjik brenda datës 30 Qershor 2011. Këshilli i Ministrave e shqyrton dhe me vendim e miraton atë bashkë me tavanet përfundimtare të Programit Buxhetor Afatmesëm 2012-2014.

## **F. Procedurat për Përgatitjen e Kërkesave Buxhetore të Programit**

29. PSHP - Sistemi i Planifikimit të Shpenzimeve të Programit është software-i që ekipet e menaxhimit të programeve në çdo ministri/institucion buxhetor duhet të përdorin për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2012-2014.
30. Aksesit në këtë software bëhet i mundur nëpërmjet GOVNET.
31. Në rast të problemeve teknike lidhur me mungesën e aksesit në GOVNET, Nëpunësi autorizues/Koordinatori i GSBI së institucionit përkatës do t'i drejtohet zyrtarisht për këtë problem Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave duke vënë në dijeni gjithashtu dhe Nëpunësin e Parë Autorizues të Ministrisë së Financave.
32. Për institucionet që kanë mungesë aksesit në GOVNET, procedurat e Përgatitjes së Kërkesave Buxhetore të Programit do t'i realizojnë nëpërmjet programit të EXCEL-it, sipas formateve të paraqitura në **Aneksin 9**.

### **F. 1. Rishikimi i Politikës së Programit**

33. Rishikimi i Politikës së Programit (RPP), starton procesin e përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2012-2014. Nëpërmjet këtij procesi, të gjitha Ministrinë e Linjës/Institucionet Buxhetore duhet të hartojnë një Deklaratë të Politikës së Programit për secilin program shpenzimesh. Kjo deklaratë do të hartohet duke u bazuar në reflektimin e objektivave të miratuara nga Ministrinë e Linjës, gjatë procesit të monitorimit të strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale të kryer në zbatim të urdhërit të Kryeministrit nr 139 dt. 1.07.2010 “Për zbatimin e procesit të monitorimit të strategjive sektoriale e ndërsektoriale”. Deklarata e Politikës së Programit do të përbëjë një pjesë integrale të Dokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm.
34. Procedura që do të përdoret për Rishikimin e Politikave të Programit, jepet në **Aneksin 3**.

### **F. 2. Planifikimi i Shpenzimeve të Programit**

35. Planifikimi i Shpenzimeve të Programit (PSHP), është bërthama e procesit të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2012-2014. Procedurat që do të përdoren për Planifikimin e Shpenzimeve të Programit, jepen në **Aneksin 4**.

### **F. 3. Kërkesa Shtesë për Shpenzime në Programin Buxhetor Afatmesëm 2012-2014.**

36. Çdo propozim për shpenzime më të mëdha se ato të lejuara në tavanin përkatës të Udhëzimit duhet të paraqitet në Ministrinë e Financave në formën e **Kërkesave Shtesë të PBA-së**.
37. Kërkesa Shtesë për Shpenzime në Programin Buxhetor Afatmesëm 2012-2014, mund të paraqiten, duke përdorur raportet e software-it të Planifikimit të Shpenzimeve të Programit, me firmën e Nëpunësit Autorizues, **jo më vonë se data 29 Prill 2011**.
38. Në paraqitjen e Kërkesës Shtesë për Shpenzime në Programin Buxhetor Afatmesëm 2012-2014, Nëpunësi Autorizues duhet të përshkruajnë se cili është kufizimi i vetëm më i rëndësishëm në implementimin e politikës së programit, si dhe çfarë veprimesh do të mund të ndërmerreshin për të lehtësuar këtë kufizim. Këto veprime, mund të përfshijnë kërkimin e fondeve shtesë ose lehtësime legislative apo politike. Kërkesa duhet të përfshijë gjithashtu një shpjegim se pse ministria/institucioni përkatës nuk mund të sigurojë një kursim eficient nga Programet e tjera. Miratimi i Kërkesës Shtesë për Programit Buxhetor Afatmesëm 2012-2014, për një ose më shumë ministri/institucion, do të kërkojë ri-alokimin e burimeve nga programet më pak prioritare të Ministrive/institucioneve të tjera, në momentin kur Tavanet e PBA-së do të vendosen nga Këshilli i Ministrave.
39. Çdo kërkesë për financime shtesë prezantuar në Programin Buxhetor Afatmesëm 2012-2014, por që paraqitet përtej afateve të përcaktuara në këtë udhëzim nuk do të përfshihet në draftin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2012-2014 që do t'i dërgohet për miratim Komitetit të Planifikimit Strategjik dhe Këshillit të Ministrave.
40. Çdo kërkesë për financime shtesë, prezantuar në Programit Buxhetor Afatmesëm 2012-2014 por që nuk reflekton qartë implikimet në kostot lokale, TVSH, shpenzime korente etj, nuk do të përfshihet në draftin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2012-2014 që do t'i dërgohet për miratim Komitetit të Planifikimit Strategjik dhe Këshillit të Ministrave.

#### F. 4. Procedurat e Menaxhimit te Investimeve Publike

41. Procedurat e Menaxhimit të Investimeve Publike, jepen në **Aneksin 5** të këtij Udhezimi. Procedurat e Menaxhimit të Investimeve Publike përcaktojnë ciklin e projekteve të investimeve si edhe në detaje të gjitha hapat që duhet të ndërmerren për përgatitjen e propozimeve për projekte investimi. Ky udhëzim i kërkon Ministrive të Linjës/Institucioneve Buxhetore zbatimin e plotë të këtyre procedurave në të dy raundet e përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2012-2014 dhe të Buxhetit Vjetor.
42. Të gjitha projektet e investimeve të përfshira në Programit Buxhetor Afatmesëm 2012-2014 (si me financim të brendshëm ashtu edhe me financim të huaj) duhet t'i nënshtrohen Procedurave të Menaxhimit të Investimeve Publike ose VKM nr.775 datë 24.09.2010 “Për administrimin e financimeve të huaja në Republikën e Shqipërisë”, si më poshtë:
- *Të gjitha projektet e investimeve të përfshira në të tre vitet e Programit Buxhetor Afatmesëm 2012-2014, duhet të identifikohen në bazë të procedurave dhe kërkesave dhe informacionit për projektet e investimeve në software-in e PSHP-ve.*
  - *Për çdo projekt, investimi për të cilin kërkohet financim nga Buxheti i vitit të parë të Programit Buxhetor Afatmesëm 2012-2014, pra viti 2012, Institucionet Buxhetore duhet të plotësojnë dhe të dërgojnë tek Ministria e Financave,*
    - Formularin F2 - “Formulari i Projekt-Propozimit per Investim” – (FPPI), dhe për projekte të kategorisë së dytë (*shiko procedurat ne Aneksin 5*), F2 të shoqerohet edhe me
    - Formularin F3 – “Formulari i Analizës Kosto-Përfitim (FAKP). sipas kërkesave të plota të procedurave të menaxhimit të investimeve publike.
43. Kurset e Këmbimit për 2011, 2012 dhe 2013 dhe përtej 2014, për efekt të parashikimeve buxhetore, do të jetë kursi mesatar i vitit 2009 i Bankës së Shqipërisë. Theksojmë se kurset per 2012-2014 nuk përbëjnë parashikime.

Nr	Monedhat	V.2007	V.2008	V.2009	V.2010	V.2011	V.2012	V.2013	V.2014
1	Kurs I kembimit mesatar lek/USD	90.4	83.9	95	103.9	105	104	104.5	104.3
2	Kurs I kembimit mesatar lek/EURO	123.9	122.8	131.5	137.8	139.1	139	139.2	139.2

#### G. Raportet – Pjesë e Kërkesave Buxhetore

44. Kërkesat e Programit Buxhetor Afatmesëm 2012-2014, paraqiten zyrtarisht, në Ministrinë e Financave së bashku me një relacion shoqërues të firmosur nga Nepunesi Autorizues dhe përmbajnë:
45. “Raportet standarte” që gjenerohen nga software-i i Programit Buxhetor Afatmesëm 2012-2014, si më poshtë vijon:
- *Misionin e Ministrisë dhe Strukturën e Programeve*
  - *Deklaratat e Politikës së Programit*
  - *Tavanet e Ministrisë sipas Programeve*
  - *Shpenzimet e Ministrisë sipas Programeve*
  - *Shpenzimet e Programeve sipas Artikujve*
  - *Shpenzimet e Programeve sipas Produkteve*
  - *Projektet me Financim të Brendshëm*
  - *Projektet me Financim të Huaj*
46. Raportet e Kerkesave Shtese, janë:
- *Kërkesat Shtesë sipas Produkteve;*
  - *Kërkesat Shtesë sipas Artikujve Buxhetorë;*
  - *“Forma A” për argumentimin e kërkesës shtesë (në fund të **Aneksit 4**).*
47. Raportet e Projekteve të Investimeve, janë (**shiko Aneksin 5.A**):
- **Formulari F2** – *Formulari i Projekt-Propozimit për Investim (FPPI);*
  - **Formulari F3** – *Formulari i Analizës Kosto-Përfitim (FAKP).*
48. Këto kërkesa duhet të përfshijnë gjithashtu Format Plotësuese të Buxhetit, për të 3 vitet e PBA-së, të paraqitura në **Aneksin 7/A**. Dorëzimi i këtyre formave bëhet vetëm në raundin e dytë pas rishikimit të



kërkesave buxhetore në bazë të taveve përfundimtare të dërguara përmes udhëzimit plotësues të buxhetit (Seksioni K i këtij udhëzimi).

49. Të gjitha raportet duhet të jenë të firmosura nga Drejtuesi i EMP-ve dhe Nëpunësi Autorizues.
50. Për institucionet që kanë mungesë aksesimi në GOVNET, kërkesat buxhetore do të paraqiten nëpërmjet formateve standarte në EXCEL, të paraqitura në **Aneksin 9**.
51. Të gjitha raportet dhe sqarimet përkatëse të tyre duhet të dorëzohen në Ministrinë e Financave, **jo më vonë se data 29 Prill 2011**.

## **H. Analiza dhe Vlerësimi i Kërkesave Buxhetore**

52. Kërkesat buxhetore të dorëzuara do të analizohen nga ekupe të përbashkëta pune ku do të marrin pjesë përfaqësues të Ministrisë së Financave, DEBASKON dhe MIE.

### **H. 1. Roli i Ministrisë së Financave në fazën e Analizës së Kërkesave Buxhetore**

53. Gjatë analizës së Deklaratës së Politikës së Programit dhe Planifikimit të Shpenzimeve të Programit, roli kryesor i Ministrisë së Financave është të sigurojë nëse ministritë/institucionet buxhetore kanë alokuar burimet financiare në përputhje me politikat dhe prioritetet e Qeverisë. Gjithashtu, ky institucion analizon kërkesat buxhetore në kuadrin e përdorimit ekonomik, eficient dhe efektiv të burimeve të Qeverisë.

### **H. 2. Roli i Departamentit të Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj (DEBASKON), në fazën e Rishikimit të Politikës së Programit (RPP)**

54. DEBASKON pranë Këshillit të Ministrave, si struktura përgjegjëse për koordinimin e strategjive sektoriale e ndër sektoriale dhe për përgatitjen e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI), luan rolin kryesor në shqyrtimin e Deklaratave të Politikave të Programeve. Detyra kryesore e këtij Departamenti ka të bëjë me vlerësimin e përputhshmërisë së Deklaratave të Politikave me të gjitha dokumentet e miratuara nga Këshilli i Ministrave apo Kuvendi dhe që janë aktualisht në fuqi.

### **H. 3. Roli i Ministrisë së Integritimit, në fazën e Rishikimit të Politikës së Programit dhe Planifikimit të Shpenzimeve të Programit**

55. Ministria e Integritimit, si pjesë e ekipit të analizës, analizon Deklaratën e Politikës së çdo Programi dhe produkteve e aktiviteteve të paraqitura nga ministritë e linjës/institucionet buxhetore për të siguruar që janë reflektuar të gjitha detyrimet që burojnë nga procesi i Integritimit Europian dhe Plani Kombëtar i Veprimtimit për Zbatimin e MSA.

### **H. 4. Negociatat me Ministritë e Linjës/Institucionet Buxhetore (Aneksi nr. 8)**

56. Përkatësisht në periudhat **18-31 Maj 2011 dhe 19-30 Shtator 2011**, Ministria e Financave do të zhvillojë takime negociuese me të gjithë anëtarët e GSBI-ve të ministrive të linjës/Institucionet buxhetore, gjatë të cilave do të diskutohen kërkesat për Programin Buxhetor Afatmesëm 2012-2014 të dërguara prej tyre dhe do të jepen rekomandimet përkatëse nga ana e Ministrisë së Financave. Rekomandimet përfundimtare do të jenë pjesë e Draftit të Parë të Programit Buxhetor Afatmesëm 2012-2014 që do të dërgohet në Komitetin e Planifikimit Strategjik dhe në Këshillin e Ministrave si edhe duhet të mbahen në konsideratë nga ana e ministrive të linjës /institucioneve buxhetore gjatë Raundit 2 të rishikimit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2012-2014 (shiko **Aneksin 8**).

## **I. Monitorimi dhe Vlerësimi i Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2012-2014.**

57. Siç përcaktohet edhe në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.4 datë 27.01.2011 "Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2011", të dërguar të gjitha Ministrive/institucioneve buxhetore, nëpërmjet shkresës së Ministrisë së Financave nr.1840/1 datë 27.01.2011, i cili është i disponueshëm në faqen e internetit të Ministrisë së Financave ([www.minfin.gov.al](http://www.minfin.gov.al)), Ministritë e linjës/institucionet buxhetore duhet të paraqesin në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit, brenda datës 28 të muajit pasardhës të çdo tremujori, raportin e monitorimit të buxhetit 2011 sipas tre-mujoreve, si dhe brenda datës 30.01.2011 raportin vjetor të monitorimit të buxhetit 2010.
58. Raporti i monitorimit konsiston në:
  - Paraqitjen e informacionit sipas kërkesave të përcaktuara në udhëzim duke:

- Përdorur software-in e PBA-së për ato ministri/institucione që mund të përdorin softin, ose duke plotësuar formatet e përcaktuara në Udhëzimin për Zbatimin e Buxhetit të vitit 2011 me të dhëna të cilat janë të rakorduara me planin e buxhetit dhe realizimin në fakt të thesarit.
- Shoqëruar tabelat me një relacion shpjegues për çdo program, si dhe një relacion përmbledhës për ministrinë /institucionin.
- Analizën e performancës së buxhetit e cila përmban:
  - Evidentimin e arritjeve për çdo program dhe në total për ministrinë/institucionin që do të thotë: A është realizuar qëllimi dhe objektivat e politikës së programit? Misioni i Ministrisë?
  - Realizimin e produkteve në krahasim me planin si në terma sasiore ashtu edhe në vlerë duke evidentuar edhe koston për njësi, si dhe nënvizimi i argumenteve konkrete për çdo realizim të produkteve dhe shpenzimeve.
  - Konkluzionet, duke bërë lidhjen e realizimit të objektivave dhe qëllimit të politikës së programit me realizimin e produkteve dhe shpenzimeve, si edhe propozimet konkrete lidhur me rishikimin ose jo të politikës së programit, apo propozime të tjera për përmirësimin e situatës.
- Publikimin e raporteve të monitorimit në faqen zyrtare të cdo Ministrie/Institucioni, dhe në të njëjtën kohë edhe në faqen zyrtare të Ministrisë Financave realizuar kjo, nëpërmjet linkut të vendosur për këtë qëllim.

## J. Ndjekja e Procesit dhe Mbështetja Këshillimore

59. Ministria e Financave do të organizojë në ambientet e saj takime me të gjithë Nëpunësit Autorizues të Ministrive të Linjës/Institucionet buxhetore për të diskutuar progresin dhe shqetësimet që mund të lindin gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit. Këto takime do të organizohen përkatësisht në datat:
  - Takimi i parë, ditën e premte, në datën 11 Mars 2011, ora 12:00
  - Takimi i dytë, ditën e premte, në datën 25 Mars 2011, ora 12:00
  - Takimi i tretë, ditën e premte, në datën 08 Prill 2011, ora 12:00
  - Takimi i katërt, ditën e premte, në datën 22 Prill 2008, ora 12:00
60. Ndjekja dhe zbatimi me përpikmëri e këtij Udhëzimi nga ana e Ministrive të Linjës/Institucioneve Buxhetore do raportohet rregullisht nga Ministri i Financave tek Komiteti i Planifikimit Strategjik, dhe Këshilli i Ministrave.
61. Ministria e Financave, në kuadër të mbështetjes këshillimore për përgatitjen e PBA 2012-2014, vë në dispozicion për çdo ministri të linjës/institucioni buxhetor adresën email: [budget.programming@minfin.gov.al](mailto:budget.programming@minfin.gov.al).

## K. Udhëzimi Plotësues i Përgatitjes së Buxhetit

62. Pas miratimit nga Këshilli i Ministrave të Draftit të Parë të Programit Buxhetor Afatmesëm 2012-2014, Ministria e Financave **brenda datës 08 Korrik 2011**, nxjerr Udhëzimin Plotësues të Përgatitjes së Buxhetit.
63. Nëpërmjet këtij Udhëzimi, ministrive/institucioneve buxhetore do t'u dërgohen tavanet përfundimtare të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2012-2014, të miratuara nga Këshilli i Ministrave, të cilat do të shërbejnë për rishikimin e kërkesave të PBA 2012-2014 nga të gjitha institucionet në raundin e dytë, në përputhje me tavanet e rialokuara.

## MINISTER I FINANCAVE

---

**RIDVAN BODE**

Konceptoi: Xhoana AGOLLI  
 Konfirmoi: Gentian OPRE  
 Konfirmoi: Mimoza DHEMBI